
 Republika e Kosovës Republika Kosovo	Drejtoria Komunale për Arsim		 Komuna e Istogut Opština Istok
	05.Nr.210/2019	Data:17.04.2019	

Në bazë të nenit 11 paragrafi 1 dhe nenit 18, paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenit 15 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Drejtoria Komunale për Arsim shpall:

KONKURS

Titulli i vendit të punës : Zyrtar/e për Biblioteka 1 Gjinnazi "Haxhi Zeka" Istog
Numri i Referencës : RN00004696 **Grada:** Niveli i koeficient 4.8

Titulli i vendit të punës : Zyrtar/e për Biblioteka 1 Shmt "Mithat Frasheri" Gjurakoc
Numri i Referencës : RN00004701 **Grada:** Niveli i koeficient 4.8 me mundesi transferi në ndonje shkoll tjetër.

Titulli i vendit të punës : Zyrtar/e për Biblioteka 1 Shfmu "Trepça" Banjë **Numri i Referencës :** RN00004702 **Grada:** Niveli i koeficient 4.2

Numri i ekzekutuesve: për secilën pozitë nga një.

Lloji i pozitës: I karrierës

Orari I plotë: 40 orë në javë

Kategoria Funktionale: Niveli Profesional

Kohëzgjatja e emërimit: Pa afat

Kohëzgjatja e periudhës provuese : 12 muaj.

Qëllimi i vendit të punës: Zbaton Strategjin dhe planin gjithëpërfshirës në biblioteken e shkollës.

Detyrat dhe Përgjegjësit :

- 1.Në bashkëpunim me udhëheqësin harton dhe zhvillon planet e punës për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të njësisë dhe jep rekomandime lidhur me realizimin e këtyre objektivave ;
- 2.Dhënja e librave dhe materialeve tjera për shërbim në bibliotekë;
- 3.Siguron përpilimin e regjistrit të librave të humbur për plotësimin e tyre me fotokopje;
- 4.Përkujdeset për funksionimin e programit lidhur me librat, si dhe bënë përpunimin e librave në këtë program;
- 5.Formon kartoteken dhe jep informacione përdoruesve;
- 6.Përkrahë zhvillimin e shërbimeve bibliotekare dhe asiston në vlerësimin e këtyre shërbimeve;
- 7.Siguron arkivimin dhe mirëmbajtjen e librave;
- 8.Kryen dhe detyra tjera në përputhje me ligjet të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

Kushtet e pjesëmarrjes në Rekrutim :

Të drejtë për punësim kanë të gjithë personat e moshës madhore të cilët kanë zotësi për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë e duhur për kryerjen e detyrave të punës.

Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara:

- Diplomë universitare, fakulteti filologjik, edukimit, shoqëror, filozofik dhe administratë publike, pa përvojë ose SHL dy vite përvojë;
- Aftësi komunikuese, negociuese dhe bindëse që i ndihmon procesit të punës ;
- Shkathtësi në caktim të objektivave, planifikim të punës dhe analizë ;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access dhe Internetit).

Afati i konkursit : Konkursi është i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga data e publikimit.

Dokumentet e kërkuara : Diploma mbi kualifikimin, diplomat e lëshuara nga institucionet shkollore jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara nga MASHT-i, dëshmi për përvojën e punës ata që e posedojnë, certifikata që nuk jeni nën hetime origjinal, dokumenti i identifikimit, ekstrakti i lindjes. Kopjet e dy raporteve të fundit të njëpasnjëshme të vlerësimit të punës (të punësuarit), si dhe certifikata tjera mbi trajnimet. Duhet të jetë banor i Republikës së Kosovës.

Paraqitja e kërkesave : Aplikacionet merren në Qendrën për Shërbim me Qytetar, kati i I-rë, Zyra nr. 100 dhe kërkesat e plotësuara dorëzohen personalisht në të njëjtën zyre.
"Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë "
"Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës "

- Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen
- Për shkak të numrit të madh të kërkesave, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Drejtori i DKA-së
Hajrush Shoshi

